

Stimulimi i nxënsëve në arsim

Kjo broshurë i dedikohet projektit për emancipimin e të rinjëve në arsim. Idea për krijimin e këtij projekti më ka lindur duke parë disa probleme të ndryshme të cilat ekzistojnë në shkollat kosovare. Duke parë se shumë pak kujdes ka në këtë drejtim, kam vendosur që ta jap kontributin tim duke krijuar një program me të cilin do të mundohem që së paku ti zbusë këto probleme.

Tema e parë që do të realizohet përmes projektit "Shkolla" është: Stimulimi i nxënsëve në arsim. Me anë të kësaj broshure ne vetëm kemi parashtruar disa probleme aktuale të cilat ekzistojnë në shkollat kosovare (dhe mbarë shqiptare) ndërsa rreth punimeve tjera dhe aktiviteteve që do të organizojmë, do sjellim broshura të veqanta. Më poshtë kemi prezantuar përmbajtjen që do të ketë kjo broshurë duke vendosur anash edhe sponsorët që e përkrahin këtë projekt. Sponzori kryesor i projekteve në Rinia 21 është ndërmarrja Faton Media www.fatonmedia.com

- **Problemi i stimulimit**
 - prezantimi
- **Shkaku**
 - përse ndodhin këto gjëra
- **Realizimi**
 - si mund ta realizojmë
- **Përfitimi**
 - prezantimi
- **Analiza e projektit**
- **Burimet e materialeve**



Problemi i stimulimit

Interesimi i nxënësve në mësim ka qenë në nivel të ulët pothuajse që prej dy dekada dhe sidomos kohëve të fundit gjithçka ka marrë një kahje tjetër. Edhe pse tani kemi një teknologji më të avancuar në të gjitha fushat, çështja e arsimit ka ra në një nivel më të ulët.

Rinia kosovare nuk ka një objekt të caktuar se çka vërtet ata dëshirojnë të studiojnë në të ardhmën apo së paku ta përfitojnë një profesion (zanat) por e gjitha çka është në ideologjitë e tyre nuk përputhet me realitetin sepse të gjithë ëndërrojnë të bëhen të pasur apo të emigrojnë në vendet perëndimore, pa menduar se rëndësia e edukimit ka një rëndësi të madhe kudo që shkojnë dhe në këtë rast ideologjia e tyre nuk po përputhet me realitetin.

Në radhë të parë dua ta them se interesimi në arsim ka rënë në një nivel të ulët jo vetëm tek nxënësit por edhe tek arsimtarët dhe ndoshta të gjitha këto kanë disa arsye të cilat mundohen ti mbulojnë njëra tjetrën por disa gjëra që janë më reale mendoj se nuk kanë arsye sepse raportet dhe bashkëpunimi "nxënës – mësues – prind" mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në një edukim të mirëfillt për të cilin fatkeqsisht nuk ekziston në nivelin e duhur. Një problem i madh i cili ekziston tek shumë nxënës por realiteti me duket është lënë anash është edhe moskuptimi i gjërave elementare ashtu siq ekzistojnë dhe funksionojnë.

Arsyetimi rreth kushteve materiale për shumicën e gjërave elementare mendoj se nuk mund të mirret sot pasi ekzistojnë kushte të mjaftueshme që të praktikohen në forma të ndryshme nga të gjitha lemitë por vullneti dhe angazhimi më i madh mund të jenë faktorët që i mbulojnë këto gjëra. Mësimi në formën mekanike (të mbajturit në mend) ne duhet harruar si e kaluar e historisë sepse realiteti sot që po ndodhë po lidhet gjithçka me praktikën e cila nuk përputhet me mësimin mekanik por se sa i kuptojnë këto gjëra nxënësit kosovar ndoshta duhet bërë një hulumtim më të gjërë.

Një problem tjetër që ekziston tek nxënësit është edhe përshtatja e metodave të ndryshme që gjërat ti kuptojn me lehtë dhe nëse bëhet një hulumtim apo një eksperiment do të vijm në përfundim se shumë nxënës mesojn në mënyr mekanike dhe pas një kohe të shkurtër ata gjithçka harrojnë dhe në fakt kjo metodë mekanike qëndron tek ata vetëm sa për ta marrë një notë apo kaluar një test. Këto probleme mendoj se do të ishte mirë që së bashku duhet ti gjejm disa metoda që janë më të përshtatshme për nxënësit që ata të kenë interesim për ta mësuar një gjë të caktuar ashtu siq duhet kështu që kjo do t'ju sjell atyre vërtet dije dhe do të mbetet më gjatë në kujtesën e tyre. Ajo që është me rëndësi ata do ta kuptonin realisht se çka kanë mësuar dhe si mund ta zbatojn nëse ju nevojitet diçka në jetën e tyre të përditshme.

Rreth mangësive të nxënsëve dhe problemeve tjera që ndoshta për momentin edhe ata vetë nuk i shohin ka shumë mirëpo kuptohet të gjitha nuk mund të zgjidhen menjëherë prandaj mendoj se po të fillojm që kohë pas kohe ti zbusim këto mangësi mendoj se një ditë të gjithë këto veti negative do të shëndrrohen në veti pozitive dhe e ardhmja e nxënsëve do të jetë më e mirë me një edukim më të përforcuar.

Ka shumë gjëra që mund të diskutohen rreth moskuptimit të gjërave elementare por besoj se është e mjaftueshme së paku të ngrihet vetëdijesimi tek të gjithë, sepse zhvillimi i këtyre gjërave lidhet me njohurit elementare sikurse në sferat tjera të jetës.

Dëshiroj që t'ju bëj me dije se unë me këto ide nuk dëshiroj ti kritikoj arsimtarët apo dikë tjetër se nuk kanë punuar mjaft që nxënësit nuk kanë interesim në arsim por këtë le ta marrim si një problem shoqëror që ka mbetur në shoqërin tonë me zhvillimin e ngadalshëm të arsimit nga shkaqe të ndryshme dhe le të vazhdojm të punojm hap pas hapi në zhvillimin e arsimit ashtu siq është në shoqërit perëndimore sepse kurrë nuk është vonë edhe pse kemi mbetur pakës mbrapa me disa shoqëri tjera evropiane.

Qëllimi im kryesor është që të krijohet një urë lidhëse e cila rrit interesimin e nxënësve për edukim, vullnetin e arsimtarëve për punë dhe krijimin e kushteve më të mira për bashkëpunim duke i zbatuar në praktik ndërmjet "nxënësit – mësuesit dhe prindërit" dhe kështu së bashku do arrijm një sukses që do ti stimulonte nxënësit ti kujshojn rëndësi më të madhe arsimit dhe gjithashtu të përfitojn njohuri të reja rreth disa problemeve që i hasin në jetën e tyre të përditshme por nuk i shohin në realitet se ato po ndodhin.

Shpresoj që nuk kam lënduar askënd me mendimet dhe hulumtimet e mia që jam duke i bërë duke shpresuar se një ditë do ta gjëj përkrahjen edhe nga shumë njëerëz tjerë të vullnetit të lirë që dëshirojnë ti përkrahin fëmijët e Kosovës në krijimin e kushteve më të mira në të gjitha lëmit e jetës.

Shkaku

Gjatë paraqitjes së problemit rreth stimulimit të nxënësve në arsim disa gjëra pothuajse janë të kuptueshme për të gjithë duke marrur si shkak në shumicën e rasteve gjendjen ekonomike, mos vullnetin (si nga nxënësit ashtu edhe nga arsimtarët) dhe disa arsye tjera të cilat kanë ngecur çështjen e arsimit duke e mbajtur pothuajse në një nivel të ulët mirëpo këto janë vetëm arsye të cilat sigurisht kanë edhe një zgjidhje e cila kërkon më shumë punë dhe angazhim.

Ne i kuptojm se ndikimi i kushteve ekonomike do të reflektohet edhe tek nxënësit por nëse ne vazhdojm të presim se këto gjëra do të përmirsohen atëherë ne do të mbesim për një kohë të gjatë në gjumë por sigurisht këto probleme mund të zgjidhen duke përdorur metoda të ndryshme e një ndër ta është bashkëpunimi nxënës – mësues – prind. Si shkak tjetër i cili ndikon tek nxënësit është edhe e ardhmja e tyre në arsim ku paragjykimet janë të një shprese të zbehët e cila mund të themi nxënësit i dërgon më shumë ka pesimizmi se sa optimizmi por sigurisht ne duhet të jemi optimist dhe duhet vepruar që edhe këto barriera ti thejm së bashku.

Ka edhe disa shkaqe tjera për të cilat ne duhet hulumtuar më shumë dhe gjetur një zgjidhje e cila do ti përshtatet nxënsëve që ti stimuloj në arsim por ajo që është më e rëndësishmja ndër të gjitha, duhet krijuar një raport më të mirë bashkëpunimi ndërmjet nxënsëve, mësuesve dhe prindërve.

Realizimi

Realizimi i këtij projekti mund të bëhet në forma të ndryshme duke ju përshtatur edhe kushteve të cilat kërkohen gjatë zbatimit të projektit. Në problemin e parashtruar më lartë përmendem disa lloje të problemeve tek nxënësit ndërsa tek ne qëllimi është që të gjitha apo se paku disa nga këto veti negative të zbuten tek nxënësit dhe interesimi i tyre të rritet jo vetëm në shkollë por edhe në sferat tjera edukuese.

Ndër faktorët kryesor siq thamë do të ishte bashkëpunimi ndërmjet prindërit – nxënësit dhe mësuesit. Sa i përket realizimit nga ana jonë do të mundohemi që të krijojm një rrjet i cili do të ofronte në të gjitha shkollat broshura të ndryshme, mbajtjen e disa aktiviteteve, takime me nxënës, mësues dhe prindër, seminare, ligjerata me nxënësit etj. Të gjitha këto aktivitete do mundohemi ti bëjmë në bashkëpunim me institucionet shtetërore përkatsisht ministrinë e arsimit, organizata të ndryshme si dhe me vetë stafin e shkollave.

Përshkak të kushteve të ndryshme realizimin nuk mund ta bëjm në të njëjtën kohë nëpër të gjitha shkollat por qëllimi ynë është që të krijohet një rrjet i cili do të ketë shtrirje në tërë Kosovën dhe bashkëpunimi i këtij rrjeti me qendrat tjera do ta rrisë efikasitetin e vetë gjatë shkëmbimit të përvojave të ndryshme.

Broshurat dhe materialet tjera sipas mundësive do të mundohemi ti shpërndajm në të njëjtën kohë nëpër të gjitha shkollat duke përdorur shpërndarjen elektronike apo metodat tjera. Gjatë realizimit të këtij projekti shpresojm të hasim edhe në përkrahjen e të tjerëve.

Përfitimi

Paragjykimi dhe e vërteta janë dy çështje që nuk mund të saktësohen që në fillim por vullneti, dëshira dhe të vepruarit me gjithë zemër janë çështje që anojn ka ana pozitive prandaj edhe përfitimi nga realizimi i këtij projekti do të mvaret nga vullneti, dëshira dhe përkrahja e të tjerëve.

Ne po mundohemi që me realizimin e këtij projekti të përfitojm një shoqëri më të frytshme në të gjitha aspektet dhe të realizojm atë thëninën popullore që thotë "rinia është e ardhmja e kombit". Ne të gjithë e dimë se një edukim më i mirëfillt i shoqërisë sonë do të sillte shumë gjëra pozitive në të gjitha sferat e jetës por ne nuk e kemi të gjithë një përkushtim të njëjtë që e ardhmja e fëmijëve mvaret edhe nga përkrahja jonë që do të ndikonte shumë tek ta.

Sigurisht shumë prej lexuesve do të thoshin se ne të gjithë i kushtojm rëndësi të madhe kësaj çështje por ne nuk po i shohim këto rezultate në jetën praktike sepse krahasimi me vendet tjera që kanë sistem më të zhvilluar të arsimit e tregon më se lehti të vërtetën prandaj edhe ne le ti lemë anash kritikën, arsyetimet dhe le të punojm më shumë që standartet e fëmijëve tonë ti arrijn me shoqëritë tjera.

"Nëse sot investojm në rini 1 €, nesër (pas disa viteve) do i fitojm 10 € "

Analiza e projektit

Suksesi i projektit sigurisht do të mvaret edhe nga analizat, kritikën, vërejtjet dhe sugjerimet tjera të cilat do të bëhen kohë pas kohe gjatë rrjedhës së projektit. Ne i mirëpresim të gjithë bashkëpunorët që ti shprehim mendimet e tyre rreth idesë, qëllimit dhe çështjeve tjera që i përkasin projektit.

Te analizat e projektit do të hyjn edhe raportet 3 mujore të cilat do ti sjellim pas një pune të përbashkët me nxënësit dhe arsimtarët. Përveq analizave tona ne do ti marrim edhe mendimet e ekspertëve tjerë që mirrem me çështjet e arsimit. Duke shpresuar se projekti ynë do të ketë një sukses në mbarë Kosovën le të presim për raportet e para të cilat do ti prezantojm tek webfaqja zyrtare www.rinia21.com

Burimet e materialeve

Ideja dhe të gjitha materialet e këtij projekti janë realizuar nga

Faton Krasniqi
www.fatonkrasniqi.com